

VENDIM
Nr.34, datë 21.7.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Hilmi Dakli Anëtar i ""

Veli Budo Anëtar i ""

Zija Vuci, Anëtar i ""

Franc Jakova, Anëtar i ""

Kristofor Peçi, Anëtar i ""

Halil Kopani, Anëtar i ""

Alfred Karamuço, Anëtar i ""

me sekretare Drita Filto, më datën 14.7.1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.39 Akti që i përket:

KËRKUESE: PARTIA SOCIALISTE, e përfaqësuar nga avokat Fatmir Gjika.

SUBJEKT I INTERESUAR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, i përfaqësuar nga sekretari, Z. Thimjo Kondi.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.1320, datë 5.7.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për zonën elektorale nr.6.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi përfaqësuesin e kërkuarit, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Partia Socialiste ka kërkuar pranë Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimin e Vendimit nr.1320, datë 5.7.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të komisionit të zonës nr.6 dhe shpalljen e paligjshme të zgjedhjeve në këtë zonë, ku ka fituar kandidati i Partisë Demokratike.

Kërkesa e Partisë Socialiste i konsideron të paligjshme zgjedhjet në zonën 6 për shkak se pretendon se janë lejuar shkelje lidhur me listat e zgjedhësve, janë bërë zgjedhje në tre lokale private si dhe ka pasur manipulime me fletët e votimit dhe me procesverbalet e votimit.

Përsa i përket pretendimeve për manipulime në fletët e votimit dhe procesverbalet përkatëse, kërkuar nuk paraqiti ndonjë provë. Për më tepër, ai pranoi se në procesverbalet e qendrave të votimit anëtarët e komisioneve nuk kanë parashtruar asnjë vërejtje për rregullshmërinë e votimeve.

Lidhur me sa pretendohet për parregullsi në listat e zgjedhësve, Gjykata çmon se ato nuk janë të një natyre të tillë që do të ndikonin në ndryshimin e rezultatit të zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 24 e 25 të ligjit nr.7561 , datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29. 4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", si dhe nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë" , njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.